

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Mekanike si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik me karakter mësimor në pozicionin “Laborant” në Departamentin e Prodhim Menaxhimit, grupi mësimor i Teknologjisë Mekanike duhet të plotësoj kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare “Master i Shkencave” në Inxhinieri Mekanike, me profil “Prodhim dhe Menaxhim Industrial”.
2. Të ketë notë mesatare të ciklit të dytë “Master i Shkencave” mbi 7 (shtatë).
3. Të ketë njohuri në përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve laboratorike, makinerive metalprerëse, si dhe njohuri në fushat e kërkimit shkencor të teknologjisë mekanike si teknologjitë konvencionale të punimit me heqje ashkle, saldimit etj., si dhe në teknologjitë speciale si përpunimi me lazer, plazma etj.
4. Të ketë përvojë të avancuar në fushën e modelimit 3D me programe inxhinierike si: SolidWorks, Autodesk Inventor, Sketch UP etj. Përvoja në këtë drejtim duhet të vërtetohet përmes eksperiencës së mëparshme ose certifikatave të lëshuara nga institucione të akredituara përkatëse.
5. Të paraqesë dëshmi/certifikatë të njohjes së gjuhës së huaj, të vërtetuar përmes testeve të njohura ndërkombëtare. Preferohet gjuha angleze në nivel akademik, minimum B1 sipas Kornizës Europiane të Përbashkët të Referencës për Gjuhët.
6. Të demostrojë aftësi të mira bashkëpunuese dhe komunikuese me personelin akademik dhe ndihmësakademik.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **22.10.2025** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.